

## AKT THEMELIMI

I

### SHOQUERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Spahija & CO"

Sot, më datë 22/07/2024,

Bujar Spahija shtetas shqiptar, i ditëlindjes 24/02/1971, lindur në Shkoder, mbajtës i karte ID H10224089J, vendosi të themeloi një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

#### NENI 1

##### Themelimi

Emri i shoqerisë është "Spahija & CO". Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "Spahija & CO" SHPK

#### NENI 2

##### Qëllimi i krijimit të Shoqerisë

Objektivi i shoqerisë do jetë aktiviteti në fushën e: Shitje dhe shperndarje me pakice dhe shumice te artikujve ushqimore, kafe, piye alkoolike dhe joalkoolike.

#### NENI 3

##### Emri dhe vula e Shoqerisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "Spahija & CO" Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

#### NENI 4

##### Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqerisë do jetë aktiviteti në fushën e: Shitje dhe shperndarje me pakice dhe shumice te artikujve ushqimore, kafe, piye alkoolike dhe joalkoolike.

#### NENI 5

##### Selia e Shoqerisë dhe Afati

Selia e Shoqerisë ndodhet në adresen Rruga Djepaxhije, ndertesa me nr pasurie 7/682 – N1, zona kadastrale 8591, Shkoder 4001.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



## NENI 6

### Kapitali i Shoqerisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqerisë është në vlerën **100.000** (njeqind mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë ku kuota ka vlerën **100.000** lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare me emrin "**SPAHIJA & CO**" zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

**Bujar Spahija** shtetas shqiptar, i ditëlindjes 24/02/1971, lindur në Shkoder, kartes ID H10224089J zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjisacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit ku një kuotë ka vlerën **100.000** lekë.

Kapitali eshte 100% shqiptar

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

## NENI 7

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqeritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqerisë.

## NENI 8

### Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

## NENI 9

### Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet **Z. Bujar Spahija**, shtetase shqiptare, lindur më 24/02/1971 lindur dhe banuese në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **H10224089J**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi te kompanisë.

Afati: 22/07/2024 – 22/07/2029

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqerisë dhe legjisacionin në fuqi.



## **NENI 10**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## **NENI 11**

Organizimi dhe funksionimi i shoqerisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

## **NENI 12**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqerisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqerisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmtojnë shoqerinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## **NENI 13**


Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

## **NENI 14**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

## **ORTAKËT THEMELUES**

**Bujar Spahija**

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Bujar Spahija". Below the signature is a stylized initials "BS".